



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 03-03/DPK Nr. Prot. 01-1140/16
 Dep. 02 Br. Prot. 16.03.2016
 Nr. f. faq. 02 Data 16.03.2016
 Broj stranica 02 Datum 16.03.2016
 Nr. pages 02 Date 16.03.2016
 PRISHTINE



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
 ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	15/03/2016
REFERENC-Ë:	AKK- DPK- DPKPP-03-03/1065/16
PËR/ZA/TO:	z. Jetulla KABASHI Zyra e Prokurimit – Komuna Rahovec
CC:	z. Idriz VEHAPI Kryetar Komune – Komuna Rahovec
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin: “Furnizim me material teknik për nevojat e Komunës së Rahovecit”



I nderuar z. KABASHI,

Në mbështetje të nenit 142 par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 par. 1, nën par. 1.1 dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 par. 4, 9 par. 1, nën par. 1.6, 12 par. 2 dhe 19 par. 1, nën par. 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin: “Furnizim me material teknik për nevojat e Komunës së Rahovecit” me numër prokurimi: 623/16/008/121, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin me titull: “Furnizim me material teknik për nevojat e Komunës së Rahovecit” me numër prokurimi: 623/16/008/121, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin Nr. 04/L -237 dhe ligjin Nr. 05/L-068

A r s y e t i m

Ju si zyre e prokurimit pranë autoriteti kontraktues Komuna e Rahovecit kenë iniciuar Procedurën e Prokurimit me titull: “Furnizim me material teknik për nevojat e Komunës së Rahovecit” me numër prokurimi: 623/16/008/121, e cila është publikuar në faqen elektronike të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik më datë 01/03/2016. Për këtë aktivitet të prokurimit kenë paraparë procedurë të hapur për furnizim.

Agjencia Kundër Korrupsion ka identifikuar këtë aktivitet të prokurimit si lëndë për trajtim. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion për këtë procedurë të prokurimit në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, Agjencia kundër Korrupsion ka hasur në specifikacione që janë në kundërshtim me ligjin në fuqi për Prokurimin Publik në Kosovës.

Në Dosjen e Tenderit, Pjesa II. Përshkrimi i çmimeve: në pikat: 4, 5, 42,116 dhe 117, janë kërkuar: Brava italiane me cilindër (komplet me dorëza); Brava italiane pa cilindër (komplet me dorëza); Hidrofor për ujë Sever. 9; Shteker nopal – dyshe; dhe Shteker nopal – njëshe. Të gjithë këta artikuj të lartë përmendur, janë kërkuar me emrat e produkteve. Autoriteti kontraktues nuk duhet të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë, ose ndonjë prodhimi.

Tutje, autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ për prodhuesit ose operatorët ekonomik. Me caktimin e emërimit të prodhuesit për produktet e kërkuara në Dosjen e Tenderit, ju si autoriteti kontraktues kenë favorizuar prodhues të caktuar, duke i diskriminuar të tjerët në raport me favorizuesit.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në trajtim dhe jo Diskriminimi: Nenin 27 Dosja e Tenderit si dhe Nenin 28 Specifikimet teknike të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin Nr. 04/L -237 dhe ligjin Nr. 05/L-068

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsion rekomandon anulimin e kësaj Procedure të Prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i shmang dhe të mos i përsëris praktikatat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

